



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19365 Prot.

Lezhë, më 06 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 125 Datë 02 / 12 /2022

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 120, DATË 29.07.2021 "PËR MIRATIMIN E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË DHE
PËRBËRJES SË TYRE"**

Mbështetur ne Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, gërmat b dhe d, neni 53, neni 54 gërma a) dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me Vendimin Nr. 54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, e konfirmuar me Nr. 358/1 Prot., datë 15.05.2020 nga Prefekti i Qarkut Lezhë, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Në pikën 2. të VKB nr. 120, datë 29.07.2021 "Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe përbërjes së tyre" të bëhen këto ndryshime:
 - 1/I. Në Komisionin e Sigurisë Publike dhe Emergjencave znj. Elsa Zefi të zëvendësohet nga z. Valentin Frani.
 - 1/II. Në Komisionin e Mirëqenies Sociale znj. Brunilda Tuku të zëvendësohet nga znj. Armanda Ndoka.
 - 1/III. Në Komisionin e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve dhe Emërtimeve znj. Regjina Sokolaj të zëvendësohet nga z. Gjon Ndoci.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryesia e Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDÏE LULI



Prot 193 65/1
Dh. 13.12.22
K 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 885/6 Prot.

Lezhë, më 13.12.2022

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 16 pika 2, germa “a” dhe “b”, në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, germa “b” dhe “d”, neni 54 germa “a”, neni 55 pika 3, në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me vendimin Nr.54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, e konfirmuar me Nr.358/1, Prot , datë 15.05.2020 nga Prefekti i Qarkut Lezhë, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.125, datë 02.12.2022 të këshillit të bashkisë Lezhë, “Për disa ndryshime në vendimin nr.120, datë 29.07.2021 “Për miratimin e të komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe përbërjes së tyre”.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

